



Datë: 26.05.2025

Numër Protokolli: 3535/2025

A.nr.560/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.560/2025, të datës 27.03.2025, të parashtruar nga ankuesja H.B. të cilën e përfaqëson Avokat Albatri Bytyqi nga Suhareka, kundër organit të punësimit/Komuna e Suharekës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.560/2025, e datës 27.03.2025, e parashtruar nga ankuesja H.B.

II. Mbetet në fuqi Aktvendimi 01 Nr. 016-17284, i datës 19.03.2025, i u.d Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile H.B. (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 24.03.2025, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 27.03.2025 dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.560.2025, kundër Aktvendimit 01 Nr. 016-17284, të datës 19.03.2025, të u.d Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës, për shkak të shkeljeve procedurale administrative, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.04.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Suharekës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2065/2025 e datës 27.03.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; prokurë3n për përfaqësim; Kërkesën e datës 11.03.2025 e parashtruar nga ankuesja tek Njësia për Menaxhimin e

Burimeve Njerëzore ne Komunën e Suharekës; Aktvendimin 01 Nr. 016-17284, të datës 19.03.2025, të u.d Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës; Vendimin 01-Nr.020-8571 të datës 23.02.2018 të Kuvendit Komunal të Suharekës; Vendimin 01-Nr.16-6343 të datës 28.01.2022 të Kuvendit Komunal të Suharekës; Lista e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi që kanë marr pjesë në takimin e mbajtur më datë 19.03.2021, 14.04.2021, 09.06.2021, 17.08.2021, 08.10.2021, 16.12.2021, 25.02.2022, 15.04.2022, 14.06.2022, 19.08.2022, 18.10.2022, 14.12.2022, 10.02.2023,14.04.2023, 15.06.2023, 16.08.2023, 13.10.2023, 19.12.2023, 13.02.2024, 16.04.2024, 18.06.2024, 21.08.2024, 09.10.2024, 17.12.2024; Vendimin 01-Nr.16-1338 TË DATËS 28.02.2014; Zarin e datës 24.03.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.04.2025; Vendimin me numër protokolli 3102/2025 të datës 12.05.2025 për shtytjen e afatit për vendosje të ankesës së ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e **pabazuar**, sepse:

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se, Kuvendi i Komunës së Suharekës më datë 23.02.2018 ka nxjerr Vendim 01 Nr. 020-8571 për themelimin e këshillit komunal për siguri në bashkësi e ku ankuesja është caktuar anëtare e këtij këshilli, po ashtu Kuvendi i Komunës së Suharekës më datë 28.01.2022 ka nxjerr Vendim 01 Nr. 16-6343 për themelimin e këshillit komunal për siguri në bashkësi e ku ankuesja është caktuar anëtare e këtij këshilli.

Ankuesja përmes përfaqësuesit të saj më datë 11.03.202, ka parashtruar kërkesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Suharekës, bazuar në vendimet e cekura më lartë, ka kërkuar kompensimin për dymbëdhjetë takime dhe kompensimin prej 600 Euro ose 50 euro për një takim, ndërsa për dymbëdhjetë takime tjera në vlerën 2,154.00 Euro apo 179.55 euro për një takim. U.D Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Suharekës më datë 19.03.2025 ka nxjerr Aktvendim 01-Nr.-16-17284, me të cilin ka refuzuar kërkesën e palës ankuese.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Aktvendimit 01 Nr. 016-17284, të datës 19.03.2025, të u.d Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës, pretendon se kompensimi për këtë çështje është i paraparë me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, kështu refuzimi i kërkesës është i padrejtë dhe në këtë rast vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat e LPPA-së. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të detyrohet Komuna e Suharekës që të bëjë kompensimin në vlerën prej 2,754.00 Euro dhe me kamat prej 8% në vit, ose të anulohet në tersi akti i kundërshtuar me ankesë dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë.

Marrë për bazë natyrën e çështjes në procedurë ankimore Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Nenit 2 paragrafi 1 dhe 2, ndërlidhur me nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ku përcaktohet se: *“1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. 2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës;... neni 87 : Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”* dhe si rrjedhojë erdhi në përfundimin se dispozitat e nenit 87, të ligjit përkatës të punës gjejnë zbatim edhe në trajtimin e kësaj çështje administrative.

Andaj, referuar përcaktimeve ligjore si më sipër, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstaton se pretendimi ankimor i ankueses për kompensimin e të ardhurave që rrjedhin sipas Vendimit 01-Nr.020-8571 të datës 23.02.2018 të Kuvendit Komunal për Suharekës, deri tek parashtrimi i kërkesës me datë 11.03.2025 kanë kaluar tre (3) vite, në kuptim të nenit 87 të Ligjit

Nr.03/L-212 të Punës dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankueses është i pabazuar, sepse Vendimi 01-Nr.020-8571 i datës 23.02.2018, ka qenë në fuqi deri më datën 28.01.2022 dhe sipas shkresave të lëndës ankuesja nuk ka ndërmarr ndonjë veprime juridik ndërlidhur me të drejtat e pretenduara nga ky vendim.

Lidhur me pretendimin e ankimor të ankueses për kompensim si rezultat i Vendimit 01 Nr. 16-6343 të datës 28.01.2021 të Kuvendit të Komunës së Suharekës, Kolegji i Këshillit, se edhe në këtë rast duke marr parasysh që ky vendim ka filluar se zbatuari nga data e nxjerrjes, atëherë ankuesja nga data e nxjerrjes së këtij vendimi nuk ka ofruar asnjë dëshmi që të ketë ndërmarr ndonjë veprim në raport me pretendimet e saj, dhe për rrjedhojë duke marr parasysh faktin se në vitin 2022 më konkretisht në dhjetor është miratuar Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili ka paraparë mënyra të tjera të kompensimit për zyrtarët publikë dhe kompensimet për zyrtarët publikë bëhet vetëm sipas këtij ligji dhe akteve nën ligjore për zbatimin e tij, rrjedhimisht me këtë ligj apo me nenin 45 paragrafi 2, është përcaktuar: *Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji*, me çka mund të konkludojmë se me këtë dispozitë është shfuqizuar edhe Udhëzimi Administrativ Nr. 27/2012 për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, vetëm në aspektin e pagave apo kompensimeve.

Po ashtu, Kolegji sjell në vëmendje se Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i është nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë, e ku këtij vlerësimi i është nënshtruar edhe neni 45 paragrafi 2 i këtij ligji, andaj edhe Gjykata Kushtetuese sipas Aktgjykimit për rastin nr. KO79/23, ka shpall të pavlefshëm paragrafi 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me efekt veprimi nga dita e hyrjes në fuqi të këtij aktgjykimi. Rrjedhimisht, në pjesën arsyetuese të Aktgjykimit për rastin Nr.KO79/23, lidhur me pa pajtueshmërinë me Kushtetutën të paragrafit 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, si dhe çështjen e efekteve juridike të këtij aktgjykimi në raport me ligjin e kontestuar, më konkret në pikën 377 të aktgjykimit, është specifikuar se : *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 2 i nenit 2 (Fushëveprimi) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi), në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafi 5 i nenit 25 (Shtesa e performancës) dhe paragrafi 4 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën për sa i përket pavarësisë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese, me theks në institucionet e përcaktuara përmes Kapitullit VII [Sistemi i Drejtësisë], Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura]. Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, (i) paragrafi 2 i nenit 2 të Ligjit të kontestuar ua pamundëson institucioneve të pavarura kushtetuese që në përmbushje të pavarësisë së tyre kushtetuese të funksionojnë edhe me ligje të veçanta dhe e kufizon pavarësinë e tyre funksionale, organizative dhe buxhetore vetëm në nxjerrjen e akteve nënligjore në rrethanat e përcaktuara specifikisht sipas Ligjit të kontestuar; (ii) paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit të kontestuar shfuqizon çdo dispozitë të ligjit dhe akt nënligjor që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorive tjera në fushën e pagave, përfshirë të gjitha dispozitat e ligjeve të veçanta që ndërlidhen me institucionet e pavarura kushtetuese dhe aktet e tyre nënligjore; dhe (iii) paragrafët 2 dhe 3 të nenit 42 të Ligjit të kontestuar të lexuar së bashku me paragrafin 2 të nenit 2 të tij, i detyrojnë institucionet e pavarura kushtetuese që t'i nënshtrohen kontrollit të pushtetit ekzekutiv lidhur me përcaktimin e ekuivalencave, përkatësisht krijimin e funksioneve pozitive dhe emërtesave në institucionet e tyre në kundërshtim me garancitë përkatëse kushtetuese dhe praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës”,*

Në kontekst të analizimit të bazës si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin së më Aktgjykimin për rastin Nr.KO79/23, Gjykata Kushtetuese ka shpallur të pavlefshëm paragrafin 2 të nenit 45 të Ligjit

Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, vetëm në raport me institucionet e pavarura kushtetuese dhe rrjedhimisht në dispozitivin e aktgjykimit, ka detyruar Kuvendin e Republikës së Kosovës, si organ legjislativ që brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi të ndryshojë dhe plotësoj paragrafin 2 të nenit 2 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ashtu që, të qartësohet shprehimisht se institucionet e pavarura kushtetuese rregullojnë dhe zbatojnë procedurat përkatëse të ligjit të kontestuar, jo vetëm përmes akteve nënligjore, por edhe ligjeve të veçanta në përputhje të plotë me pavarësinë e tyre funksionale, organizative dhe buxhetore të garantuar me Kushtetutë. Pra, pavlefshmëria e paragrafit 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Pagat në Sektorin Publik nuk mund të ndërlihet me institucionet e tjera shtetërore.

Në fakt, Gjykata Kushtetuese përmes konstatimeve të dhëna në pjesën **IV. Efektet e Aktgjykimit**, ka sqaruar me pikën 376. *Konstatimet e Gjykatës sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, ndikojnë në efektet e këtij Ligji në dy mënyra. E para ndërlihet me konstatimet e Gjykatës lidhur me sistemin e pagave dhe shpërblimeve dhe procedurave përkatëse për atë sa afektojnë pavarësinë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese; ndërsa e dyta ndërlihet me konstatimet e Gjykatës lidhur me zbritjen e nivelit të pagës së funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të Shtojcave të Ligjit të kontestuar, sipas sqarimeve në vijim:..”,* Për me tepër bazuar në sqarimet e dhëna përmes pjesës **IV. Efektet e Aktgjykimit**, me konkret nga pika 373 e deri tek pika 388, arrihet në përfundimin se paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, është shpallur i pavlefshëm vetëm në raport me Institucionet e Pavarura Kushtetuese dhe Sistemit të Drejtësisë. E duke marr parasysh këtë Kolegji i Këshillit, vlerëson se mbi këtë bazë nuk mund të bëhet kompensimi sipas Udhëzimi Administrativ Nr. 27/2012 për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, kurse çështjet, llojet dhe mënyrat e kompensimeve janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, gjegjësisht sipas nenit 35.

Marr parasysh se caktimi i ankueses si anëtare e këshillit komunal për siguri në bashkësi, përbën funksion shtesë atëherë sipas Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, gjegjësisht sipas nenit 5 duhet të plotësohen e mënyrë kumulative të gjitha kushtet e parapara për kompensimin për funksion shtesë e që ankuesja nuk i plotëson në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat ligjore, të përcaktuar me nenin 5 të kësaj rregulloreje, sepse është nëpunëse e vet institucionit që e ka themeluar këshillin, e që në këtë rast ky është kushti që nuk mund të plotësohet.

Andaj, nisur nga konstatimet si me lartë, e në kuptim të ligjshmërisë së aktit të kontestuar më ankesë Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së dispozitivi i Aktvendimit 01 Nr. 016-17284, të datës 19.03.2025, të u.d Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës, është plotësisht i ligjshëm mirëpo arsyetimi i vendimit do të ishte mbi bazën e konstatimeve sikurse në këtë vendim, kështu që duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *3. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar,* Kolegji i Këshillit, bazuar në këtë dispozitë ligjore, vlerëson se dispozitivi apo pjesa urdhëruese e aktit të kundërshtuar është e drejtë, ndërsa, arsyetimi i vendimit të kontestuar zëvendësohet me arsyetimet sikurse në këtë vendim.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.560/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të Ankueses Avokat Albatri Bytyqi;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.